

VIRGJËRESHAT E PËRBETUARA SHQIPTARE: DUKURI ZAKONORE, OBJEKTE STUDIIMI DHE SUBJEKTE TRAJTIMI

ALBANIAN SWORN VIRGINS: CUSTOMARY OCCURRENCES, STUDY OBJECTS AND THEMATIC SUBJECTS

ARBNORA DUSHI

Instituti Albanologjik – Prishtinë, Rr. Eqrem Çabej, p.n. 10.000 Prishtinë
Email: arbnoradushi@hotmail.com

Përmbledhje

Në kuadër të temës së Simpoziumit “Femra shqiptare në arte dhe shkenca”, punimi im do të hedhë dritë mbi fenomenin e lashtë të traditës shqiptare – “virgjëreshat e përbetuara”, femrave që në emër të ruajtjes së nderit, fati u ka diktuar që të mos martohen kurrë dhe të bëjnë jetë burrash. Ky zakon i lashtë i malësisë, i kodifikuar edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, është tipik për bashkësitë patriarkale që kanë jetuar në zona të thella malore ku liria e lëvizjes së femrave, ishte e kufizuar, si në Shqipërinë e veriut dhe në Kosovë. *Virgjëreshat e përbetuara*, ndonëse sot janë ‘racë në zhdukje’, ende i gjejmë të gjalla dhe edhe pse të moshuara, ato rrëfejnë për fatin që kanë pasur në jetë. Ky fenomen antropologjik nuk i shpëtoi as penës së shkrimtarëve, dhe sot përveçse se si fenomene të studiuara, *virgjëreshat e përbetuara* janë edhe personazhe romanesh, dhe prania e këtij fenomeni në studime dhe në vepra letrare, do të jetë tema e punimit tim.

Fjalët kyçe: femra, virgjëresha të përbetuara, traditë shqiptare, nder, beqari.

Abstract

My paper which is part of the Symposium “Albanian woman in Arts and Sciences” will flash a light on the old occurrence of Albanian tradition – the “Sworn Virgins” – women who swear for life celibacy and take the social role of men in the name of honour. This old traditional custom codified with the Kanun of Lekë Dukagjini was typical for patriarchal communities who lived in deep mountain zones where the freedom of movement for women was limited, like in Northern Albania and Kosovo. Albanian Sworn Virgins even that today are a “disappearing race” we still can find them alive and register their personal life narrative.

This anthropologic phenomenon was attractive for writers also, and today except as a studied phenomena, Albanian Sworn Virgins are literary personages as well. The presence of ASW in studies and literary works will be the topic of my paper.

Hyrje

Shoqëria tradicionale shqiptare ishte shoqëri patriarkale, patrilineale dhe patrilokale, çka nënkupton se ishte shoqëri e bazuar në njësinë e familjes në krye të së cilës ishte babai, i cili i kishte të gjitha përgjegjësitë për mirëqenien e familjes dhe kishte autoritet mbi të tjerët në familje, se trashëgimia përcillej vetëm nëpërmjet linjës mashkullore dhe se me rastin e martesës gruaja shkonte të jetojë në shtëpinë e burrit. Këto përgjithësisht e nënkuptojnë se qëllimi kryesor i lidhjes dhe i bashkimit të çiftit ishte vazhdimësia e llojit mashkullor, pra vazhdimësia e trashëgimitarit mashkull në familje. Kur e kemi të njohur këtë veçori tipike të shoqërisë shqiptare, shumë zakone e doke tradicionale, të cilat i gjejmë të shënuara në Kanunin e Lekës e që e kanë origjinën në traditat e jetuara me shekuj ndër shqiptarë, i gjejmë të shpjegueshme dhe të arsyetuara.

Virgjëreshat e përbetuara shqiptare: dukuri zakonore

Në familjen shqiptare tradicionale, ku qëllimi kryesor i saj ishte lindja e trashëgimitarit mashkull, në rastet kur ishte e pamundur për ta arritur një rezultat të këtille, tradita e ka prodhuar fenomenin e krijimit të mashkullit surrogat, pra krijimin “artificial” të mashkullit, duke i ndryshuar identitetin gjinor njëres nga bijat e familjes.

Djali në traditën shqiptare ishte krah i prindit, ishte trashëgimtar i emrit të familjes, trashëgimtar i pasurisë, ishte vijues i linjës mashkullore, ishte krah i punës në fushë, ishte ai i cili do t’ia nxirrte gjakun të

atit në rast gjakmarrjeje, ishte ushtar potencial për luftë, me një fjalë ishte gjithçka për familjen dhe mungesa e tij e nënkuptonte një familje “të porealizuar”. Të gjitha këto çonin në gjykimin se familja shqiptare duhet të kishte patjetër djalë dhe po s’e pat, atëherë duhej ta “shpikte”. E në raste pamundësie për të pasur së paku një djalë në familje, prindërve u duhej të vendosnin që vajzën e fundit ta shpallnin djalë, duke e edukuar që nga lindja të bënte jetë mashkulli. Madje këtë punë duhej ta pranonin si një fakt të kryer dhe sekretin ta ruanin gjatë tërë jetës së tyre. Kjo, për vetë vajzën që kishte ardhur në jetë me fat të predestinuar – të plotësonte vendin e djalit në familje - do të nënkuptonte flijim të identitetit të saj gjinor.

Djali përveç që ishte një “specie” e kërkueshme dhe e nevojshme për rolin trashëgues, ishte edhe ruajtës i nderit të familjes, cenimi i të cilit, sipas kodit kanunor, do të ndëshkohej deri edhe në marrje të jetës, të gjakut – me vrasje. Nderin e femrës, të bijës, të nënës, të motrës, të gruas do ta ruante babai, biri, vëllau e burri shqiptar. Në rastet kur femra do të bënte ndonjë punë “të pandershme”, siç mund të ishte refuzimi i saj për t’u martuar me burrin që ia kishte caktuar familja, sipas kodit kanunor, ajo do të shtynte familjen e të atit në gjak, duke i sjellur kështu të atit e të vëllait, “gjakun në derë”, të cilët tani do t’i kishin borxh familjes së të dhëndrrit një gjak, për shkak se “e bija, e motra” iu kishte kthyer “fjalën”. Kanuni thotë: Po s’ndigioi vajza me shkue m’at fat, qi e kâ xânë, e edhe prindja i perkrahen së bis, kjo s’mund të martohet mâ për të gjallët e dhandrit me tjeterekend (Gjeçovi, 1986, 58). Në raste të këtilla femra shqiptare, për të evituar gjakmarrjen, do të merrte vendim të shpallej mashkull, duke zgjedhur të shkurtojë flokët si burrat, të vishej si burrat, të merrte emër burri, të bëjë punë burrash e përfundimsihtë të bëjë jetë burrash. Kjo ndër të tjera do të thoshte edhe privim i plotë i saj nga jeta seksuale, privim nga natyra e saj si qenie biologjike, si femër, çka e nënkuptonte se status i i saj socialo-martesor do t’ishte që të mbetej virgjëreshë e përjetshme.

Deklarimi publik i këtij statusi, pra të deklaruarit se prej tash e tutje do të jetë Virgjëreshë, do t’i bënte asaj vendin midis burrave nëpër oda, (por jo edhe të drejtën e fjalës. Kanuni thotë: Virgjinat (femnat qi veshen si burrë): s’vëçohen prej grâsh tjera, posë qi janë të lira me ndejë nder burra, porse pa tagër zânit e kuvendit. (Gjeçovi, 1986, 152), do t’i jepte të drejtën e mbajtjes dhe përdorimit të armës, të drejtën e mbajtjes së “sahatit me qystek” siç e mbanin burrat, të drejtën e mbajtjes së plisit, të veshjeve të burrave, do t’i jepte të drejtën e pronës, të drejtën e gjakmarrjes, të drejtën e pjesëmarrjes në luftë si mashkull, të pjesëmarrjes në ushtri (siç do të njihen raste të

mëvonshme), pra me një fjalë të drejtën e ruajtjes së emrit dhe nderit të të atit, mashkullit paraprijës në familje të cilit po i trashëgohej linja mashkullore, “lisi i gjakut” (Gjeçovi, 1986, 115). Kjo zgjedhje do t’i jepte asaj shumë respekt në shoqëri dhe do të çmohej e do të nderohej si midis burrave ashtu edhe midis grave e fëmijëve, të cilët nuk do t’ia kontestonin asnjëherë gjininë “e fituar”. Ajo do të cilësohej me emër dhe përemër mashkullor.

Shkaqet për të cilat është bërë ky transformim i rolit social të femrës janë: (1) për të fituar trashëgimtar (në këto raste vendimi merrej nga prindërit), (2) për t’i ikur gjakmarrjes (vendimi e merrte vetë vajza atëherë kur nuk dëshironte të martohej me burrin që ia kishin caktuar familja), dhe (3) për të ruajtur nderin apo për të nxjerrë gjakun (ajo e merrte vendimin pasiqë i vdisnin prindërit). Në një mjedis patrarkal çfarë ishte shoqëria shqiptare, ku lindte, edukohej e rritej femra shqiptare, këto shkaqe shërbenin si motive mjaft të forta për ta shtyrë atë në një vendim të këtille – privim nga identiteti i saj femëror. Aty ku pozita e saj ishte palakmueshme, ku lëvizja e saj nuk lejohej jashtë mureve të shtëpisë, ku nuk kishte të drejtë fjalë, nuk kishte të drejtë trashëgimie dhe ku shërbente vetëm për të lindur fëmijë dhe si krah pune, me marrjen e këtij vendimi ajo brenda natës do të fitonte të drejta të mëdha, do të bëhej bëhej mbajtëse e familjes apo edhe kryefamiljare. Me ndryshimin social të rolit gjinor, si kundërshtpërblim ajo do të fitonte disa forma të lirisë, të cilat deri atëherë ekzistonin vetëm për meshkuj. Duke u bërë burrë ajo do të fitonte të drejtën për të jetuar e lirë në një botë mashkullore. (Linda Gusia, cituar sipas Bilefsk).

Virgjëreshat e përbetuara: objekte studimi

Për praninë e këtij fenomeni na bëhet e ditur që në Kanunin e Lekë Dukagjinit (i botuar 1933), që është një grumbull kodesh, nenesh e rregullash juridike të jetës shoqërore të shqiptarëve, të cilat deri atëherë kanë qenë të pashkruara, por që janë zbatuar me përpikëri nga shqiptarët që para shekullit XV, duke e bërë që shoqëria shqiptare të funksionojë nën një sistem juridik. Duke e cilësuar KLD e Gjeçovit si një dëshmi të sistemit kodifikues të jetesës së shqiptarëve, e konsiderojmë se që në Mesjetë fenomeni i Virgjëreshave të përbetuara shfaqet si zakoni tradicional shqiptar, i kodifikuar me Kanun.

Më vonë shumë nga misionarëte huaj që kaluan dhe jetuan midis shqiptarëve në periudha të caktuara, mbetën të mahnitur me këtë “krijesë”, duke shprehur shenja respekti për vendimin e saj, por pati edhe të tillë të cilët shoqërinë shqiptare e panë si shoqëri barbare dhe të paqytetëruar dhe edhe këtë fenomen nuk e panë me sy pozitiv, madje shpesh duke i dhënë

edhe kuptimin e perversiteteve e devijimeve seksuale. Konsuli austriak për Ballkanin dhe albanologu i njohur Johann G. von Hahn, në librin e tij *“Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit”*, të botuar gjermanisht në Vjenë më 1867, ku i përshkruan përjetimet e tij në këto vise, në vitin 1863, flet për katër virgjëresha shqiptare të cilat i kishte takuar në Shqipëri, për të cilat thotë se ndërronin seksin (gjininë) duke i prerë flokët, duke veshur rroba burrash, duke marrë emër burri dhe ai shkruan se ky ndërrim bëhej nën mbrojtjen e kishës, ku i bëhej me dije bashkësisë fshatare, të mbledhur aty në mënyrë solemne, se filan virgjëresha ka vendosur t’i kushtohet një jete të virgjër, duke kërkuar që prej sot e tutje ta njohin si mashkull (Hahn, 2001, 87).


E mirënjohura, mis Edith Durham, për fenomenin e Virgjëreshave do të shkruajë në veprat e veta e vet *“High Albania”* të botuar më 1909, si dhe në veprën *“Some Tribal Origins, Laws, and Customs of the Balkans”* të botuar më 1928. Durham në këto vepra e përshkruan në hollësi fenomenin e Virgjëreshave të përbetuara shqiptare, shkruan për takimet e drejtpërdrejta që ka pasë me to si dhe i analizon rrethanat që i kanë shtyer ato për të marrë atë vendim. Në analizimin e riteve familjare dhe kodeve kanunore në lidhje me këto tradita, Durham shkruan se vajza shqiptare blehet që në djep ose që pa lindur dhe kur ajo të rritet ndodhë që refuzon të martohet me burrin që e ka blerë, me atë rast jo vetëm që do t’i mbetet babait të saj t’ia kthejë paratë të atit të djalit, por ajo do ta çojë familjen e saj drejt gjakmarrjes, ku familja e djalit, e fyer në këtë rast nga refuzimi, do të kërkojë gjak nga familja e vajzës për të kthyer në vend nderin (Durham, 2000, 482).



Kjo fotografi e Virgjëreshës shqiptare nga Rapsha gjendet në librin e Durhamit *“High Albania”*, botim i vitit 1909.

Ndonëse ky fenomen nuk kalon pa u përmendur, përshkruar dhe analizuar, më shumë ose më pak nga gazetarë e misonarë të tjerë, më tepër të huaj se shqiptarë, vëmendjen më të madhe do t’ia kushtojë antropologia angleze Antonia Young në studimin e vet monografik *“Albanian Sworn Virgins: Women who become Men”* (*“Virgjëreshat e përbetuara shqiptare: Gratë që bëhen burra”*), të botuar në vitin 2000 në Oxford.

Fenomeni i virgjëreshave nuk mbeti pa u regjistruar e studiuar edhe nga hulumtuesit e studiuesit shqiptarë. Ndonëse ishte tipik për Shqipërinë veriore, ky fenomen kishte shtrirje të gjerë edhe në Kosovë, e cila edhe pse mbijetonte nën një administrim paksa më të ndryshëm socialist, organizimi i familjes dhe shoqërisë shqiptare mbetej i njejtë. Kanuni zbatohet njësoj. Virgjëreshat ose Tybelitë (nga fjala turke tybe – përбетим, pra që janë përbetuar të mos martohen) u trajtuan si fenomen etnografik në punimin e etnologut Kadri Halimi, i cili bëri hulumtime brenda periudhës 1947-1960, në disa zona të Kosovës, prej nga solli 27 shembuj nga terreni. Duke i sjellë dëshmitë me emra e mbiemra dhe nga zonat e hulumtimit, ai përshkroi rastin e secilës si dhe shkaqet që i sollën deri te ai vendim. Prej këtyre shembujve pati raste që ishin



Kopertina e librit te Antonia Young-ut

përkushtuar tërë jetën këtij identitetit mashkullor, por pati edhe të tilla që pas vdekjes së prindërve iu ishin kthyer identitetit të vet gjinor dhe madje edhe ishin martuar dhe kishin lindur fëmijë (Halimi, 2000, 53).

Ajo bëri hulumtime të thella në zonat malore shqiptare, në Shqipëri e në Kosovë, jetoi midis shqiptarëve, mori pjesë në ceremonitë e tyre familjare dhe arriti t'i njohë për së afërmi Virgjërëshat shqiptare. Njohu aktivitetin e tyre familjar e shoqëror, analizoi botën e tyre emocionale dhe raportet me njerëzit e familjes e të fshatit. Sipas saj në fillim të viteve '90 ekzistonin rreth njëqind Virgjërësha të përbetuara shqiptare. Me një respekt të madh për flijimin e jetës së tyre emocionale në emër të mirëvajtjes së familjes dhe në emër të ruajtjes së nderit, Young virgjërëshat shqiptare i cilësoi si "Burra nderi" "Honorary men" (Young, 2000, 72). Kureshtarë për botën e tyre interesante emocionale, pasiqë siç thoshte ajo këto ishin krijesa me dy gjini, të brendshmen femër dhe të jashtmen mashkull (Young 2000,111), arriti të flasë me disa nga to për temat intime dhe erdhi në përfundim se në një shoqëri ku ekzistonin ligje të rrepta mbi nderin, besën mikun e gjakmarrjen, çnderimi dhe perversitetet seksuale ishin të panjohura, sidomos për Virgjërëshat të cilat kishin sakrifikuar identitetin biologjik për ruajtjen e nderit të vet e të familjes. Në këtë studim, pas hulumtimesh e analizimesh të mëdha, Young hodhi dritë mbi këtë fenomen duke thënë se këto qenie me gjini të kryqëzuar (cross-gender), nuk kanë të bëjnë asnjëherë me ndryshimin biologjik të gjinisë së tyre, por vetëm me ndryshimin e statusit social, pra me statusin e tyre në shoqëri, madje, ato gjatë intervistimit, i kishte tmerruar e dhëna se në botën e qytetëruar gjinia ndryshohet me intervenime kirurgjike. Për mjedisin religjioz dhe shumë të varfër, ku ato bënin jetën, këto fakte ishin të pakuptueshme për mënyrën e tyre të menduarit dhe të jetuarit. Young i takoi Virgjërëshat edhe në mjediset urbane të qyteteve të veriut, të cilat pas viteve '90 kishin gjetur mundësinë e punësimit në profesione burrash (taksiste, shofere kamioni, roje objektesh publike etj.)

Virgjërëshat e përbetuara: subjekte trajtimi në letërsi

Fenomeni i Virgjërëshave të përbetuara nuk ka mbetur i patrajtuar edhe në letërsi, madje që prej shumë moti e deri në ditët tona. Figurën e vajzës së virgjër me veshje burri e cila del në dyluftim me meshkuj dhe madje edhe i mund ata, e gjejmë që në Ciklin e këngëve të Kreshnikëve. Megjithëse, në këto këngë, vajza luftëtare nuk është virgjërëshë e mirëfilltë, ashtu siç e njeh praktika e jetës zakonore, pasiqë sipas këtyre këngëve, ajo e luan këtë rol vetëm për një periudhë të caktuar apo vetëm për të kryer një mision dhe pastaj i kthehet jetës sipas natyrës së vet – femërore. *Fatimja*

e bardhë apo edhe *Çika e plakut a Motra e Gjergj Elez Alisë*, janë këngët e kreshnikëve ku i këndohet heroizmin të vajzës, e cila e mbetur e vetme, me babën plak, apo vëllaun e plagosur, pa një mashkull të fuqishëm në shtëpi, në kohën kur Bajlozi i zi, Harapi i zi, Uroshi apo ndonjë personazh tjetër armik, i kërkon mejdan trimit dhe i kërkon të bijën a të motrën për robinjë, i duhet kësaj që të trimërohet, të veshet me rrobat e t'atit apo të vëllait, të ngjeshë armët e tij dhe t'i dalë në dyluftim armikut. Duke ia këputur kokën atij, ajo arrin ta qojë në vend nderin e të vëllait a babait, nderin e familjes dhe ta ruajë veten, nderin e saj e virgjërinë, duke shpëtuar së rëni robinjë në duart e Bajlozit a Harapit. (Këngë kreshnike, 1974, 334). Zakonisht në këto këngë, vajza luftëtare, pasiqë të qojë në vend nderin e familjes, i heq rrobat e mashkullit dhe i kthehet përgatitjes për martesë (Berisha, 2009, 29). Këtë motiv e gjejmë edhe në këngën e Tringës, te "*Lahuta e Malcis*" (1941), e cila është pasqyrim i ngjarjeve historike të luftërave shqiptaro-malazeze. Njashtu si heroinat e këngëve të Kreshnikëve, edhe Tringa e Nokshiqit, e bukur, e re, e virgjër, e ka vëllaun e plagosur në shtëpi kur malazetët hyjnë në fshat për t'i sulmuar, vjedhur e djegur shtëpitë shqiptare dhe për t'i vrarë meshkujt e për t'i grabitur vajzat e reja. Në ballafaqim me ta ajo arrin të vrasë dy prej tyre, derisa i treti e vret Tringën dhe kështu ajo e gjallë nuk i bie në dorë armikut (Fishta 1996, 427).

Pikërisht temën e Virgjërëshës, me të gjitha tiparet e këtij zakoni tradicional shqiptar e gjejmë në dramën katërkëshe "Nita" (1954) të shkrimtarit arbëresh nga Zara, Josip Relës. Ngjarja zhvillohet në një mjedis tipik arbëresh të shekullit të XVII, ku malësorët shqiptarë nga fshati Brisk i Shkodrës, nga frika e sulmeve turke ishin shpërngulur në Arbënes të Zares së Kroacisë. Atje Nita, heroina e kësaj drame, para Këshillit të Pleqve shpallet mashkull, pra virgjërëshë e përjetshme, me vetëdëshirë, pasiqë në momentin e largimit nga fshati i lindjes i kishte premtuar Zefit, djalit që e dashuronte, se do ta priste përjetë. Vetëm tre muaj pas këtij ndërrimi, Zefi vie në Arbënes të Zarës dhe Nita pas takimit me të kërkon që të kthehet në gjininë e saj, por Këshilli i Pleqve para të cilëve ajo ishte betuar nuk e lejon dhe drama përfundon kur dëgjohej koburja e kuptohet se Tani (Nita), virgjërëshë e përbetuar, e kishte vrarë veten, nga pamundësia për të tejkaluar gjykimin që po i bëhej. (Rela, 1968, 173).

Tema e virgjërëshave vazhdon të ngacmojë shkrimtarët shqiptarë dhe në vitin 1959 në Prishtinë, Rexhai Surroi e boton romanin "Besniku". I frymëzuar nga histori reale të rralla të femrave nga familjet shqiptare, ai e përshkruan shumë realisht psikologjinë e fshatarit shqiptar, i cili nuk pati fatin t'i lindë djalë

edhe pas tri vajzave. I vetmi shpëtim nga ky turp ishte shkrepja e armës, me të cilën sipas zakonit lajmërohej lindja e djalit dhe kështu të shpallte se më në fund fitoi edhe ai një trashëgimtar. Sekretin e dinin vetëm ai e shoqja dhe vajza/djali të cilin e kishin ngarkuar me faktin se gjininë nuk duhet ta zbulojë, së paku jo sa të jenë gjallë prindërit. Fshehtësinë Besniku arrin ta ruajë deri në ushtri, kur edhe i vënë para pozitave të palakmueshme, detyrohet të zbulojë të vërtetën. Fatmirësisht atëherë Besniku i kthyer në Besa, nuk i kishte më prindërit gjallë dhe pas këtij zbulimi, martohet me shokun e ngushtë, i cili nuk kishte arritur ta kuptojë sekretin derisa nuk i kallëzoi vetë. (Surroi, 1959).

Një formë tjetër të temës së virgjëreshës shqiptare e sjell dramaturgu shkodran Andrea Skanjeti në dramën me tri akte "Nora" (1961). Në krahinën e Kelmendit të fillimit të shekullit XVII e cila ishte në rrezik të vazhdueshëm nga pushtimet turke, midis trimërisë së burrave kelmendas shquhet edhe një vajzë, një virgjën shqiptare me veshje burri e cila e zotëronte shumë mirë shkathtësinë e shpatës. Ashtu si edhe në rrëfimin biblik për Juditën hebreje, Nora e Kelmendit falë bukurisë e shkathtësisë së saj, arrin ta vrasë armikun e fshatit, në këtë rast pashën turk dhe të shpëtojë krahinën e Kelmendit nga dhuna sistematike e pushtuesit. (Skanjeti, 1979).

Shkrimtarja shqiptare Elvira Dones, e cila tashmë shumë vite jeton në perëndim, e shkruan romanin "Hana" (i botuar në italisht dhe në shqip në vitin 2007), ku temë trajtimi është jeta e një virgjëreshës shqiptare. Hana/Marku, ndonëse është produkt i zakonit të vjetër tradicional të Malësisë, të cilën mënyra patriarkale e jetesës e kishte detyruar të transformohet në mashkull se përndryshe do t'kish qenë e rrezikuar nga dhunimi, në romanin e Donesit i duhet të kalojë edhe një *trans* tjetër – tranzicionin e shoqërisë shqiptare të fundshekullit XX.. Rrethanat ia mundësojnë Hanës të vazhdojë jetën në Amerikë ku njeriu pranohet në shoqëri pavarësisht nga dallimet që bart dhe ajo e shtyrë edhe nga rrethi i miqve shqiptarë dhe amerikanë, do të arrijë t'i tejkalojë dallimet që ka sjellë nga bota shqiptare, dhe përfundimisht i kthehet identitetit të vet gjinor, duke arritur që të dashurohet në një mashkull vetëm pas moshës pesëdhjetë vjeçare, vetëm atëherë kur do ta lejojë të zhvillohet e lirë gjinia e vet. (Dones, 2007).

Temën e virgjëreshës shqiptare e gjejmë edhe në romanin e fundit të shkrimtarit Petraq Risto me titull "Një grua me Urdhrin e Ujkut" (Risto, 2009), roman ky

me një kompozicion modern, ku figura tradicionale e virgjëreshës, inkorporohet në rrethana të aktualitetit, duke u bërë pjesë e dashurisë, tradhtisë, xhelozisë, hakmarrjes, hetimit, madje edhe deri në masën e një enigme. Riaktualizimi i kësaj figure kaq tradicionale, duke u bërë madje edhe subjekt romani modern, e tregon autenticitetin e saj, po aq sa edhe ekzotikën që përmban ajo në vete, dhe prandaj këto cilësi vazhdojnë të provokojnë mendjet e shkrimtarëve.

Përfundim

Nga sa u tha më lartë, e pamë se fenomeni i Virgjëreshave të përbetuara shqiptare me origjinë shumë të lashtë (disa studiues origjinën ia kërkojnë te periudha e Matriarkatit dhe i afrojnë me tipin e Amazoneve nga antika greke, e disa të tjerë e lidhin me kultin e Virgo-s (Young 2000) dokumentohet që në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe vazhdon të prodhojë në vazhdimësi studime e trajtime letrare. Prania e këtij fenomeni në studime dhe në letërsi, qoftë vetëm me qëllim prezentimi, me qëllim kritike apo keqardheje, apo edhe me qëllim afirmimi të kulturës shqiptare me të gjitha virtytet dhe veset që ka, e bën të dokumentueshëm dhe madje artistik, këtë zakon tradicional shqiptar.

Bibliografia

- BERISHA, Rrustem (2009), *Maskimi në Virgjëresha në këngët popullore, Gjurmime Albanologjike*, seria folklor dhe etnologji 38/2008, Prishtinë.
- DONES, Elvira (2007), *Hana*, Sejko, Elbasan.
- DURHAM, Edith (1998), *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë e shqiptarët*, SHB Naum Veqilharxhi, Tiranë.
- FISHTA, Gjergj (1996), *Lahuta e Malcis*, Rilindja, Prishtinë.
- GJEÇOVI, Shtjefën (1985), *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Rilindja, Prishtinë, (ribotim).
- HAHN, Johan G. Von (2001), *Nëpër viset e Drinit*, Horizont, përktheu Pjetër Rodiqi, Tiranë.
- HALIMI, Kadri (2000), *Trajtime dhe studime etnologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- RELA, Josip (1968), *Vepra*, Rilindja, Prishtinë.
- RISTO, Petraq (2009), *Një grua me Urdhrin e Ujkut*, Globus R, Tiranë.
- SKANJETI, Andrea (1979), *Nora*, Rilindja, Prishtinë.
- SURROI, Rexhai (1959), *Besniku*, Rilindja, Prishtinë.
- YOUNG, Antonia (2000), *Women who become men*, Oxford, 2000.